

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	217-26-2949-1-2-1
Nr i brendshëm	217/26/015/121

Sa i përket tenderit për: “Furnizim me material mjekësor për nevojat e FSK-së”.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“MEDPLUS SH.P.K.”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Pranvera e Lirisë, p.n., Lebanë

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344640420

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jeton Prenaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


medplusks@gmail.com

(Adresa elektronike)

26.07.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 30.04.2026
Data e hapjes së ofertave: 08.06.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 10.07.2026
Kërkesa për rishqyrtim dt:15.07.2026
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 17.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 57 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është publikuar me dt. 30.04.2026, kurse njoftimi mbi vendimin e AK-së formulari B58 është ngrit në sistem me dt.15.07.2026. Nga njoftimi mbi vendimin e AK-së, jemi njoftuar se AK-ja ka rekomanduar për kontratë OE MESE PHARM SH.P.K., ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

- Ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, ku autoriteti kontraktues na ka lejuar qasje, ndërsa nga ato dokumente që na janë dhënë rezulton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar *“Kërkesa 9 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses (jo në realizim e sipër) kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme gjatë tri (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë totale jo më pak se 100,000.00 € Nëse Operatori ekonomik përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një apo dy vite, do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale të përcaktuar në dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar”*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *“Evidenca 9 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë a) Listën e kontratave të realizuara gjatë tri (3) viteve të fundit, të nënshkruar dhe vulosur nga OE; b) Referencat ose raportet e pranimit (fletëpranimet teknike), në kopje të nënshkruara dhe vulosura nga autoritetet përkatëse, të cilat duhet të përmbajnë* • *numrin e kontratës prokurimit;* • *vlerën e kontratës;* • *datën e nënshkrimit të kontratës; Vërejtje* • *Çdo kontratë duhet të jetë e shoqëruar me referencë positive, fletpranim apo raport pranimi teknik; në të kundërtën, nuk do të merret parasysh.* • *Për kontratat e realizuara për autoritete publike ose private, brenda ose jashtë Republikës së Kosovës, duhet të dorëzohen referencë positive, fletpranim apo raport pranimi teknik të lëshuara nga autoriteti përkatës, ku specifikohet edhe vlera e kontratës.* • *Për referencat nga institucionet private, duhet të dorëzohet edhe dëshmi e qarkullimit bankar për vlerën përkatëse.* • *Vetëm kontratat e përfunduara me sukses dhe të dokumentuara plotësisht do të merren në konsideratë”*.

OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur, sepse pas analizës së dokumentacionit të ofertës së tij, duke përfshirë këtu edhe dokumentet e dorëzuara pas kërkesës për sqarime të bërë nga autoriteti kontraktues, kemi ardh në përfundim që i njëjti nuk ka arritur të përmbush vlerën e kërkuar prej 100,000.00 €, sipas kërkesës së lartcekur të dosjes së tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë edhe pas sqarimeve të cilat i ka dorëzuar, nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit, sepse i njëjti në ofertë ka paraqitur një referencë në vlerë prej 6,000.00 €, e lëshuar nga Spitali Aloka SH.P.K., mirëpo për këtë referencë mungon dëshmia e qarkullimit bankar, pasi që në dosje të tenderit është kërkuar shprehimisht që për referencat e lëshuara nga institucionet private të dorëzohet edhe dëshmi e qarkullimit bankar për vlerën përkatëse;

-Është paraqitur një raport pranimi në vlerë prej 14,526.80 € i lëshuar nga SHSKUK, mirëpo për këtë kontratë mungon referenca pozitive, prandaj i njëjti nuk mund dhe nuk duhet ti merret parasysh nga ana e AK-së.

-Po ashtu është paraqitur një raport pranimi në vlerë prej 14,398.00 € i lëshuar nga SHSKUK, mirëpo edhe për këtë kontratë mungon referenca pozitive dhe e njëjta si më lartë nuk mund dhe nuk duhet të merret parasysh nga ana e AK-së.

-OE i rekomanduar për kontratë po ashtu ka paraqitur edhe një raport tjetër pranimi në vlerë prej 14,398.00 € i lëshuar nga SHSKUK, mirëpo edhe për këtë kontratë mungon referenca pozitive, prandaj edhe ky raport nuk mund dhe nuk është dashur ti merret parasysh nga ana e AK-së.

Përderisa vetë kërkesa e dosjes së tenderit e specifikon qartë se çdo kontratë duhet të jetë e shoqëruar me referencë pozitive, fletëpranim apo raport pranimi teknik dhe në të kundërtën nuk do të merret parasysh, ndërsa për referencat e lëshuara nga institucionet private kërkohet detyrimsht edhe dëshmia e qarkullimit bankar, atëherë kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit. Po ashtu, kërkesa e dosjes së tenderit e ka përcaktuar qartë se vetëm kontratat e përfunduara me sukses dhe të dokumentuara plotësisht do të merren në konsideratë. Kur kemi parasysh të lartcekurat shihet qartë se AK-ja edhe përkundër se ka specifikuar qartë kërkesat e dosjes së tenderit e njëjta ka pranuar dokumentacionin e OE të rekomanduar për kontratë i cili nuk është në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit, duke e favorizuar të njëjtin, ndërsa duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm.

Në momentin që nuk merren parasysh kontratat e lartcekura, të cilat nuk janë dokumentuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit, atëherë OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson kërkesën minimale prej 100,000.00 € për kontrata të natyrës së njëjtë ose të ngjashme gjatë tri (3) viteve të fundit, e cila kërkesë është kriter i detyrueshëm kualifikues.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e lartcekura, kuptohet qartë se AK-ja ka rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm i cili në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të rekomandohej për kontratë, prandaj kërkojmë që të analizohen edhe një herë në tërësi kërkesa e dosjes së tenderit dhe dokumentet e dorëzuara nga i njëjti dhe pastaj të nxjerret një vendim meritore në lidhje me ofertën e të njëjtit.

Me dt.17.07.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, ku e njëjta e ka refuzuar kërkesën por nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret dhe të mbështetur në dispozita ligjore në lidhje me refuzimin e bërë.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim është arsyetuar si më poshtë:

Pretendimet e juaja nuk qëndrojnë, komisioni i vlerësimit, në mënyrë të barabartë duke u thirrur dhe respektuar LPP-në nenin 59 të LPP se – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve. Komisioni ka vepruar sipas LPP-se dhe kriteret e FTD-së.

AK, ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave në mënyrë të barabartë si dhe vlerësimi i tenderëve është bërë në përputhje të plotë me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe kërkesave të përcaktuara në dosjen të tenderit dhe njoftimit për kontratë si dhe Kriterit për Dhënien e Kontratës.

Autoriteti Kontraktues - Ministria e Mbrojtës bazuar në konstatimet e cekura më lartë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material mjekësor për nevojat e FSK-së. Numri i prokurimit:217-26-2949-1-2-1, Nr i brendshëm: 217-26-015-1-2-1, ka respektuar në tërësi dispozitat e legjislacionit në fuqi, Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe legjislacionit sekondar në fuqi, andaj mbetet në fuqi njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 10.07.2026.

Vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, për faktin se në të njëjtin vendim nuk janë shqyrtuar dhe adresuar fare pretendimet e paraqitura nga ne, por AK-ja është mjaftuar vetëm me përshkrimin se komisioni ka bërë krahasimin dhe vlerësimin e ofertave në përputhje me LPP-në dhe FTD-në. Në asnjë pjesë të vendimit për refuzim nuk është dhënë arsyetim lidhur me faktet dhe provat konkrete të paraqitura nga ne në kërkesën për rishqyrtim, përkatësisht nuk është shpjeguar pse janë pranuar dokumente që nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit.

Autoriteti kontraktues pasi që nuk ka mundur në asnjë mënyrë të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore, i njëjti është munduar të arsyetohet duke mos i përmendur fare pretendimet ankimore, por vetëm duke e cekur se vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me dispozitat ligjore. Përderisa AK-ja nuk ka dhënë ndonjë arsyetim në lidhje me pretendimet tona ankimore, kuptohet qartë se të njëjtat janë të bazuara sepse në të kundërtën AK-ja do ti kishte kundërshtuar me fakte konkrete, po që një gjë të tillë nuk e ka bërë.

Kur kemi parasysh të gjitha të lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është tendencioz dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, e për më tepër i njëjti vendim është në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, paragrafi 9, ku specifikohet qartë se: *"Refuzimi do të arsyetohet dhe do t'i komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim."*

Si përfundim kur kemi parasysh të lartcekurat, kuptohet se vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pambështetur në fakte dhe duhet të anulohet, ndërsa oferta e OE të rekomanduar duhet të rivlerësohet, në mënyrë që gjatë rivlerësimit të veprohet në harmoni të plotë me dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri

kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me **çmimin më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *“Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”,* mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse ka rekomanduar për kontratë një OE që ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

- I. APROVOHET,** e bazuar ankesa e OE **“MEDPLUS SH.P.K**
- II. ANULOHET,** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-s.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.